

VENDIM
Nr. 9, datë 11.5.2020

**PËR TRANSFERIMIN E FUNKSIONIT TË MBLEDHJES SË TARIFAVE PËR TË
GJITHA KATEGORITË E MBAJTËSVE TË TË DREJTAVE TË AUTORIT DHE TË
DREJTAVE TË TJERA TË LIDHURA ME TO, NË ADMINISTRIMIN KOLEKTIV
DHE DREJTIMIN E SPORTEELIT UNIK TË ADMINISTRIMIT TË SË DREJTËS SË
AUTORIT – SUADA**

Në zbatim të nenit 138, të ligjit nr. 35, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 35, datë 18.1.2017, “Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit”; të vendimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit nr. 2, datë 20.4.2017, “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA)” dhe vendimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit nr. 8, datë 19.11.2018, “Për transferimin e funksionit të mbledhjes së tarifave për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në administrimin kolektiv dhe drejtimin e sporteli unik të administrimit të së drejtës së autorit – SUADA”, Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA), pas konsultimit të zhvilluar në mbledhjen e datës 11.5.2020, nëpërmjet platformës ZOOM, me rend dite, zgjedhja e Agjencisë unike të cilës i kalon funksioni kolektiv i mbledhjes së tarifave të shpërblimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to,

KONSTATON SE:

Me vendimin e KKDA-së nr. 8, datë 19.11.2018, Agjencia “Albautor” është zgjedhur në drejtimin e sporteli unik të administrimit të së drejtës së autorit – SUADA, me afat 1-vjeçar (njëvjeçar).

Në përfundim të afatit, në bazë të nenit 138, të ligjit nr. 35, datë 31.3.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, Agjencitë e Administrimit Kolektiv (AAK) me anë të një marrëveshjeje me shkrim bien dakord dhe vendosin cilës prej tyre do t’i transferohet funksioni i mbledhjes së tarifave për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave. Në pamundësi të arritjes së një marrëveshjeje, e drejta e zgjedhjes së AAK-së që do të drejtojë SUADA-n i kalon KKDA-së.

Me qëllim zgjedhjen e AAK-ve, KKDA-ja njoftoi hapjen e procesit të konkurrimit të AAK-ve. Në mbledhjen e vet të radhës, në datën 27.4.2020, me rend dite, prezantimi i platformave të agjencive të cilat shprehën interesin për kalimin e funksionit kolektiv të mbledhjes së tarifave të shpërblimit në kuptim të nenit 138, të ligjit 35/2016, si dhe drejtimin prej saj të sportelit unik SUADA, mori në shqyrtim dosjet me propozimet e mëposhtme:

1. Kërkesa e Agjencisë “Albautor” për Sportelin Unik për të Drejtat e Autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, me nr. protokoll hyrës nr. 1388, datë 9.3.2020;
2. Kërkesa e Agjencisë “AKDIE” për Sportelin Unik për të Drejtat e Autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, me nr. protokoll hyrës nr. 1247, datë 3.3.2020;
3. Kërkesa e Agjencisë “FMAA” për Sportelin Unik për të Drejtat e Autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, me nr. protokoll hyrës nr. 1353, datë 6.3.2020;
4. Kërkesa e Agjencisë “GRAMM-A” për Sportelin Unik për të Drejtat e Autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, me nr. protokoll hyrës nr. 1523, datë 24.3.2020.

Agjencia “AKDIE” përmes *e-mail*-it të datës 27.4.2020 u tërhoq zyrtarisht nga gara.

Kërkesa e Agjencisë “GRAMM-A” nuk u pranua për konkurrimin për sportelin unik SUADA, në kushtet e vendimit të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 158, datë 31.1.2020, i cili ka revokuar urdhrin e Ministrisë së Kulturës 2018 “Për licencimin e shoqatës GRAMM-A, si agjencia e administrimit kolektiv në fushën e mbajtësve të të drejtave të prodhuesve të fonogrameve dhe videogramëve”.

Përveç dokumenteve shkresore të depozituara, AAK-të “Albautor” dhe “FMAA” prezantuan me përfaqësuesit e tyre pranë KKDA-së, në datën 27.4.2020, platformat përkatëse për drejtimin e sportelit unik SUADA.

KKDA-ja, prej vitesh konstaton se ndërmjet AAK-ve ekziston një frymë jo e mirë bashkëpunimi, fakt ky që manifestohet në pamundësinë e vendimmarrjeve të organit më të lartë të qendrës, SUADA. Me synimin për të krijuar frymën e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit ndërmjet AAK-ve, KKDA-ja, pasi dëgjoi prezantimet e platformave për drejtimin e qendrës SUADA, me kërkesën nr. 1864 prot., datë 29.4.2020, u bëri thirrje të gjithë AAK-ve për arritjen e një marrëveshje për një kandidaturë për pozicionin e drejtorit ekzekutiv të SUADA-s që nuk ka ndonjë konflikt interesi me AAK-të apo SUADA-n. AAK-të u përgjigjën me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të SUADA-s, të datës 4.5.2020, duke mos arritur një konsensus të përgjithshëm të të gjithë AAK-ve.

Misioni i KKDA-së është garantimi dhe mbrojtja e mbajtësve të së drejtës, subjekt të të drejtave të autorit, për sa i përket shpërblimit për shfrytëzimin e të drejtave me karakter pasuror dhe jopasuror në tregun intelektual. Përveç detyrimit të përmbushjes së këtij misioni, e drejta e vendimmarrjes në përzgjedhjen e AAK-së për drejtimin e SUADA-s, ligjvënësi e ka parashikuar në funksion të zhbllokimit të gjendjeve që pamundësojnë marrëveshjen e AAK-ve për drejtimin e SUADA-s.

Në kushtet kur përsëri AAK-të nuk arritën të gjejnë dakordësinë, KKDA-ja mori në analizë propozimet e dy AAK-ve, përkatësisht “Albautor” dhe “FMAA”, si dhe në referim të pyetjeve dhe përgjigjeve të administruara në seancat dëgjimore të datës 27.4.2020, por edhe të kriterëve që kërkojnë se, SUADA duhet të ketë në drejtimin e saj një AAK e cila ka kohëzgjatje të aktivitetit të subjektit ndër vite dhe provon se ka logistikën më të përshtatshme, ekspertizën profesionale për mbulimin e territorit, kontrata të përfaqësimit të ndërsjellë me agjenci homologe dhe njohje ndërkombëtare, të ketë pasuritë e platformës më të përshtatshme dhe me koston më efektive për administrimin e të drejtave, të zotërojë infrastrukturën më të përshtatshme, përfshirë atë elektronike, e cila garanton respektimin e transparencës në mbledhjen dhe shpërndarjen e të ardhurave për anëtarët e saj dhe të zbatojë me përpikëri dispozitat për procedurën e mbledhjes së shpërblimeve, sipas ligjit për të drejtën e autorit, KKDA konstaton se:

Agjencia “Albautor”, në cilësinë e drejtuesit të SUADA-s, nuk ka implementuar një sistem elektronik i cili do të garantonte transparencën në mbledhjen dhe shpërndarjen e të ardhurave të AAK-ve. Nga ana tjetër konstatohet se forma e menaxhimit të SUADA-s nga “Albautor” ka sjellë mungesë bashkëpunimi dhe nuk ka arritur të vendosë një ekuilibër mes AAK-ve, fakt i cili është bërë shkak për lindjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre.

Nga ana tjetër, platforma e drejtimit të SUADA-s nga Agjencia “FMAA” edhe pse një platformë e pa testuar në praktikë, krijon bindjen se nëse do të zbatohet në tërësinë e saj dhe brenda afateve kohore të propozuara mund të rezultojë e suksesshme.

Sa më sipër, duke administruar të gjithë informacionin e nevojshëm dhe pas shqyrtimit të platformave të paraqitura, Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit, në zbatim të nenit 138, të ligjit 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”

VENDOSI:

1. Transferimin e funksionit të mbledhjes së tarifave për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, në administrimin kolektiv, në bazë të nenit 138, të ligjit 35/2016, agjencisë së administrimit kolektiv “FMAA”, nga data 11.5.2020 deri në datën 31.12.2021.

2. Brenda 1 (një) muaji nga publikimi i këtij vendimi duhet të bëhen ndryshimet e nevojshme në aktet e Qendrës SUADA, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Brenda 6 (gjashtë) muajve nga publikimi i këtij vendimi duhet të vihet në funksionim:

- Platforma e propozuar;
- Platforma elektronike e cila mundëson transparencën në mbledhjen dhe shpërndarjen e të ardhurave.

4. Pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, zbatohet neni 138, i ligjit 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.

5. Mënyra dhe përqindjet e ndarjes së tarifave dhe shpërblimit të mbledhur ndaj AAK-ve të kryhet në zbatim të pikës 3, të nenit 138, ligjit 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.

6. Për sa nuk bien ndesh me këtë vendim, pikat e miratuara në vendimin nr. 4, datë 10.10.2017, të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit “Për transferimin e funksionit kolektiv të mbledhjes së tarifave të shpërblimit për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, drejt njëres prej agjencive të administrimit kolektiv dhe për drejtimin e sportelit unik për administrimin e të drejtës së autorit - SUADA”, zbatohen nga SUADA.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës, si dhe në Fletoren Zyrtare.

8. Kundër vendimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit, palët kanë të drejtë të ankohen në gjykatën administrative kompetente brenda afateve të parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative. Afati i ankimit, llogaritet nga data e njoftimit/shpalljes të këtij vendimi.

9. Ngarkohet sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR I KËSHILLIT KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

Ines Muçostepa